



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština - Assembly**

---

**Legjislatura V**

*Sesioni pranveror*

Kryesia e Kuvendit

P-060

Prishtinë, më 11 maj 2016, në orën 08:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C -301

**PROCESVERBAL**

**I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 11 MAJ 2016**

Në mbledhje morën pjesë: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit; Xhavit Haliti, Sabri Hamiti dhe Slobodan Petroviq, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Elmi Reçica, Ismet Beqiri dhe Myfera Shinik.

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Blerim Latifi, Avni Bytyçi dhe Driton Lajçi.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Musli Krasniqi.

Nga OSBE-ja: Sanije Berisha.

Mbledhjen e drejtoi **Kadri VESELI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

### **Rend dite**

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Kryesisë së Kuvendit, të mbajtura më 25 prill dhe më 3 maj 2016,
2. Përgatitjet për seancën plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave dhe
4. Të ndryshme.

### **1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Kryesisë, të mbajtura më 25 prill dhe më 3 maj 2016**

Kryesia i miratoi pa vërejtje procesverbalet e mbledhjeve të Kryesisë së Kuvendit, të mbajtura më 25 prill dhe më 3 maj 2016.

### **2. Përgatitjet për seancën plenare të radhës**

Kryetari i njoftoi anëtarët e Kryesisë së Kuvendit se nga seanca plenare, e mbajtur më 28 dhe më 29 prill 2016, kanë mbetur edhe tetë (8) pika të papërfunduara. Ai propozoi që edhe këto pika të përshihen në rend dite të seancës së ardhshme.

Kryesia, pasi i shqyrtoi edhe parashtresa e tjera që plotësonin kushtet për shqyrtim në seancë plenare, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare të pranishme në mbledhje, vendosi që Kuvendi gjatë këtij muaji t'i mbajë edhe dy seanca plenare, dhe atë njëra më 18 maj 2016, në orën 10:00, me këtë

### **Rend dite**

1. *Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,*
2. *Koha për pyetje parlamentare,*
3. *Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme,*
4. *Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-093 për ratifikimin e Konventës për heqjen e kërkesës për legalizim të dokumenteve zyrtare të huaja (5 tetor 1961),*
5. *Votimi i Projektligjit nr. 05/L-095 për Akademinë e Drejtësisë,*
6. *Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 05/L-064 për patentë-shofer,*
7. *Votimi i anëtarëve të Bordit Këshillëdhënës për Mbrojtjen e Mjedisit,*
8. *Votimi i raportit të Komisionit për Integritet Evropian lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së fituar me vepër penale,*
9. *Votimi i raportit të Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 04/L-032 për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës,*
10. *Votimi i raportit të performansës së ndërmarreve publike për vitin 2014.*
11. *Shqyrtimi i parë Projektligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit,*

12. *Propozim-vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës,*
13. *Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit për Ankesa të Medieve,*
14. *Shqyrtimi i raportit të Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas për vitin 2015,*
15. *Shqyrtimi i raportit të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2015.*

Si dhe seanca tjetër më 25 maj 2016, me fillim në orën 10:00, në të cilën do të përfshihen të gjitha pikat që procedohen në ndërkohë nga komisionet parlamentare.

### **3. Shqyrtimi i propozimeve dhe i kërkesave**

*1. Njoftimi i dy (2) nënkryetarëve të Kuvendit lidhur me pjesëmarrjen në punimet e Sesionit të dytë të Rregullt të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, prej 18-22 prill 2016*

Kryesia u njoftua me raportin e nënkryetarëve të Kuvendit, z. Xhavit Haliti dhe znj. Aida Dërguti, që kishin marrë pjesë në punimet e Sesionit të dytë të Rregullt të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, në Strasburg (Francë), prej 18-22 prill 2016.

*2. Njoftimi i z. Nait Hasani, kryetar i Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport, lidhur me vizitën zyrtare të realizuar në Tiranë (Shqipëri), prej 8-10 prill 2016*

Kryesia u njoftua me raportin e z. Nait Hasani, kryetar i Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport për vizitën zyrtare të realizuar në Tiranë, Shqipëri, prej 8-10 prill 2016.

*3. Njoftimi i Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të Forcës së Siguri së Kosovës lidhur me vizitën zyrtare të realizuar në Hagë, prej 6-8 prill 2016*

Kryesia u njoftua me raportin e Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të Forcës së Siguri së Kosovës për vizitën zyrtare të realizuar në Hagë, prej 6-8 prill 2016.

*4. Njoftimi i dy (2) deputetëve të Kuvendit të Kosovë për tërheqjen nga grupet parlamentare*

Kryesia u njoftua me vendimin e deputetëve të Kuvendit: z. Ilir Deda, i cili nga data 25 prill 2016 është tërhequr nga Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” dhe aktivitetin e tij parlamentar do ta vazhdojë si deputet pa grup parlamentar, si dhe z. Ramiz Kelmendi, i cili nga data 5 maj 2016 është tërhequr nga Grupi Parlamentar i PDK-së, ndërsa aktivitetin e tij parlamentar do ta vazhdojë si deputet pa grup parlamentar.

*5. Propozimi i GP të Lëvizjes “Vetëvendosje” për zëvendësimin e anëtarit në Komisionin Parlamentar për MSA*

Kryesia, pasi u njoftua me propozimin e Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje” për zëvendësimin e anëtarit në Komisionin për MSA, mori këtë:

## Vendim

Deputetja Donika Kadaj-Bujupi emërohet anëtare në Komisionin Parlamentar për Stabilizim-Asociim BE - Kosovë, në vend të deputetit Ilir Deda.

### 4. Të ndryshme

#### *1. Kërkesa e Grupit të Deputetëve për ndërtimin e Qendrës për Takimet - Lutjet e Mëngjesit*

Kryetari i njoftoi të pranishmit se Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 22 janar 2016, e ka mbështetur nismën e Grupit të Deputetëve për ndërtimin e Qendrës për Takimet - Lutjet e Mëngjesit, dhe më 18 mars 2016 i ka kërkuar Komunës së Prishtinës që ta sigurojë hapësirën për ndërtimin e kësaj qendre.

Por, më 22 mars 2016 është tërhequr kërkesa për sigurimin e hapësirës për ndërtimin e Qendrës për Takimet - Lutjet e Mëngjesit, ngase në ndërkohë është gjetur një parcelë më e përshtatshme në Zonën Kadastrale Sofali-Prishtinë, e cila është në pronësi të Qeverisë, si dhe një parcelë tjetër, që është në pronësi të Postës dhe Telekomunikacionit të Kosovës sh.a. (PTK).

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me propozimin e lartpërmendur dhe mori këtë:

## Vendim

Kërkohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të parcelës nr. P-71914066-00233-1, Zona Kadastrale Sofali-Prishtinë, në pronësi të Qeverisë, si dhe të parcelës nr. P-71914066-00233-2, Zona Kadastrale Sofali-Prishtinë, në pronësi të Postës dhe Telekomunikacionit të Kosovës sh.a. (PTK), për ndërtimin e Qendrës për Takimet - Lutjet e Mëngjesit.

#### *2. Kërkesa për plotësimin e Organogramit të Administratës së Kuvendit të Republikës së Kosovës*

Kryetari i njoftoi anëtarët e Kryesisë së Kuvendit se në bazë të nenin 12 të Ligjit për aftësimin, riaftësimin dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara, organet e Administratës shtetërore, punëdhënësit e sektorit privat dhe publik, si dhe organizatat joqeveritare obligohen që ta punësojnë një person me aftësi të kufizuara në çdo pesëdhjetë (50) punëtorë.

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën për plotësimin e Organogramit të Administratës së Kuvendit, mori këtë:

## Vendim

1. Organogrami i Administratës së Kuvendit të Republikës së Kosovës plotësohet edhe me 4 (katër) pozita për persona me aftësi të kufizuara.
2. Punësimi i personave në pikën një (1) të këtij vendimi do të bëhet pas sigurimit të mjeteve buxhetore me rastin e rishikimit të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2016.

3. Procedurat e rekrutimit dhe përshkrimi i punëve për personat me aftësi të kufizuara do të bëhen nga Administrata e Kuvendit të Republikës së Kosovës në bashkëpunim me shoqatat e personave me aftësi të kufizuara.

Kryetari e mbylli mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit në orën 8:20 minuta.

Kryetari i Kuvendit

**Kadri VESELI**

*Procesverbalin e hartoi:*

*Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale*